



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 113/1Prot.

Tiranë, më 10 /05/ 2021

V E N D I M

Nr. 79, Datë 10 /05/ 2021

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr.101 Regj, datë 22.09.2020, që i përket ankuesit A.Ç, kundër Shoqërisë Raiffeisen Bank sh.a¹, me pretendimin për diskriminim për shkak të “gjendjes shoqërore”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi deklaron se, ushtron profesionin e avokatit, pranë Dhomës së Avokatisë Sarandë, i pajisur me me Liçencë Nr.9796 dhe me Nipt xxxxxxxxxxxx, me adresë, Lagjja Nr.1, rruga “Onhezmi”, godinë 6 katëshe, pranë Gjykatës Sarandë.

Në datën 29.07.2020 ankuesi deklaron se është paraqitur pranë Filialit të Bankës Raiffeisen sh.a, në Sarandë, për të aplikuar për të çelur llogari për ushtrimin e aktivitetit privat, si person fizik, me profesion avokat. Kishin kaluar më shumë se 10 ditë dhe ankuesi shprehet se nuk kishte marrë përgjigje nga banka në lidhje me kërkesën e bërë prej tij për çeljen e llogarisë bankare.

Në datën 09.08.2020, ankuesi deklaron se ka paraqitur kërkesë me shkrim për t’u informuar në lidhje me faktin se përse nuk i ishte çelur llogaria bankare. Raiffeisen Bank sh.a, më datë 13.08.2020, i ka kthyer përgjigje ankuesit me “sms”, në celularin e tij privat se: *“Ankesa juaj është marrë në dorëzim! Raiffeisen Bank do ju kontaktojë pasi të jenë kryer të gjitha verifikimet për rastin tuaj! Faleminderit!”*

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Banka.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Nga data 13.08.2020, e deri në ditën e paraqitjes së ankesës, ankuesi deklaroi se nuk ka asnjë përgjigje në lidhje me kërkesën e paraqitur pranë bankës, duke pretenduar se është vendosur në pozita diskriminuese.

Për shkak se Raiffeisen Bank sh.a kishte refuzuar që t'i çelë llogarinë bankare, ankuesi deklaroi se i është drejtuar Bankës "Fibank" sh.a, në Sarandë, e cila brenda 2 ditëve i ka kthyer përgjigje dhe i ka çelur llogarinë bankare të biznesit.

Ankuesi pretendon se Raiffeisen Bank sh.a, duke mos i kthyer asnjë përgjigje edhe pse ka kaluar afati 30 ditor, në lidhje me shkaqet e mos çeljes së llogarisë bankare, e ka vendosur atë në pozita diskriminuese dhe poshtëruese, në krahasim me klientët e tjerë, pa i treguar ankuesit asnjë shkak për mos çeljen e llogarisë bankare. Ankuesi deklaroi se në këtë bankë ka dhe llogarinë e tij personale dhe të bashkëshortes.

Përfundimisht, ankuesi kërkoi nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit nga Raiffeisen Bank sh.a për shkak të gjendjes shoqërore, si ish gjyqtar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në datën 18.11.2020, kanë hyrë në fuqi ndryshimet ligjore, të miratuara me ligjin nr. 124/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"³. Meqënëse çështja objekt i këtij shqyrtimi administrativ është paraqitur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 124/2020, atëherë Komisioneri vlerëson se çështja duhet të shqyrtohet sipas parashikimeve të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të pandryshuar.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma "a", të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Ligji nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", rregullon ndër të tjera, zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjendjen shoqërore, duke përcaktuar në nenin 1 të tij se: "Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, **gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore**, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër."

Bazuar në nenin 7/1, të ligjit "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", ku parashikohet se : "1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo

³ Ligji nr.124/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2020 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.191, datë 03.11.2020.

grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”, mbrojtja nga diskriminimi garantohet jo vetëm ndaj veprimeve dhe mosveprimeve nga ana e autoriteteve publike, por edhe personave fizikë ose juridike privatë.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, dhe ajo u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të këtij ligji

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.1273/2 prot., datë 25.09.2020, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Banka.
2. Me shkresën nr.22594 prot., datë 12.10.2020⁴, Banka ka dërguar qëndrimin e saj në lidhje me ankesën.
3. Me shkresën nr. 1273/4 prot., datë 22.10.2020, ankuesi pasi është njohur me parashtrimet e Bankës, ka dërguar kundërshtimet e tij.
4. Me shkresën nr. 1653 prot., datë 24.11.2020, Komisioneri ka kërkuar informacion shtesë nga Banka, e cila ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 22594/2 prot., datë 01.12.2020⁵.
5. Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁶ dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, në datën 22.12.2020 , Komisioneri zhvilloi një seancë dëgjimore. Seanca dëgjimore u zhvillua me pjesëmarrjen e të dy palëve, ankuesit, i cili ishte personalisht prezent dhe Raiffeisen Bank sh.a, përfaqësuar nga z. K.M dhe znj. M.P, punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës, të pajisur me autorizimin e datës 21.12.2020.
6. Me shkresat nr. 1623/1 prot., datë 24.11.2020 dhe nr. 1773 prot., datë 17.12.2020 Komisioneri ka kërkuar opinionin e Bankës së Shqipërisë mbi disa çështje në lidhje me ankesën.
7. Banka e Shqipërisë, ka kthyer përgjigje në lidhje me kërkesën e mësipërme për informacion me shkresën nr.5357/1 prot., datë 13.01.2021⁷. Përgjigjja e Bankës së Shqipërisë i’u komunikua palëve në rrugë elektronike në datën 19.01.2021.
8. Ankuesi paraqiti kundërshtimet e tij në lidhje me përgjigjen e Bankës së Shqipërisë, në datë 21.01.2021⁸.
9. Banka, me shkresën nr. 2718 prot., datë 03.02.2021⁹, paraqiti qëndrimin e saj në lidhje me opinionin e Bankës së Shqipërisë, duke depozituar edhe konkluzionet e saj përfundimtare në lidhje me ankesën.

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit, me nr. 1273/3 prot., datë 14.10.2020.

⁵ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1623/2 prot., datë 04.12.2020.

⁶ Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”

⁷ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 113 prot., datë 18.01.2021.

⁸ Kundërshtimet e ankuesit u administruan në rrugë elektronike.

⁹ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 244 prot., datë 04.02.2021.

II/A Prapësimet e Bankës në lidhje me ankesën

Banka shpjegon se, më datë 29.07.2020, A. Ç është paraqitur pranë Degës Raiffeisen Bank sh.a, Sarandë, ku ka kërkuar çeljen e një llogarie rrjedhëse për A.Ç (PF), regjistruar ne NUIS xxxxxxxxxxxx, për aktivitet privat të Personit Fizik, me profesion avokat. Nga ana e Bankës, janë kryer verifikimet dhe vlerësimet përkatëse në lidhje me aplikimin për çelje llogarie biznesi dhe në përfundim të këtij procesi është vendosur që të refuzohet hapja e llogarisë së biznesit për këtë klient, pra, banka të mos hyjë në një marrëdhënie biznesi me këtë subjekt.

Pretendimi i ankuesit se është diskriminuar nga ana e Bankës, pasi nuk i është çelur llogaria rrjedhëse, është i pabazuar dhe si i tillë nuk duhet të pranohet, për arsyet e mëposhtme:

Së pari: Lidhur me të drejtën e Bankës për të mos çelur llogari rrjedhëse dhe pavarësinë e saj në lidhje me administrimin dhe drejtimin.

Refuzimi për çeljen e një llogarie bankare, është një e drejtë ligjore e Bankës dhe nuk mund të pretendohet *apriori*, se një veprim i tillë përbën një veprim diskriminues, në kuptim të ligjit. Si të gjitha kontratat e tjera të parashikuara nga Kodi Civil, kontrata bankare është një kontratë që mund të lidhet vetëm me pëlqimin e të dyja palëve, të cilat shprehin vullnetin e tyre për të hyrë ose jo në një marrëdhënie juridike.

Ligji nuk përcakton detyrimin e bankës që të lidhë kontratë, të hapë llogari dhe të hyjë në marrëdhënie biznesi në çdo rast kur i paraqitet një kërkesë nga një aplikant. Në parim, banka është e legjitimuar të refuzojë aplikimin e një klienti për hapjen e një llogarie bankare, në rastet kur bëhet fjalë për klientë që paraqesin risk të lartë, sipas vlerësimit që bëhet duke u bazuar në kërkesat e ligjit dhe procedurat e saj të brendshme. Kjo është një e drejtë që e kanë bankat kudo në botë, pavarësisht rregullimeve të ndryshme ligjore që mund të kenë.

Së dyti: Nuk jemi para rastit të diskriminimit në ofrimin e shërbimeve bankare.

Banka prapëson se ankuesi nuk është në kushtet e diskriminimit, në kuptim të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pasi refuzimi i ofrimit të shërbimit për ankuesin nuk është për ndonjë prej shkaqeve diskriminuese, të parashikuara nga neni 1 i këtij ligji.

Në rastin konkret nuk jemi në kushtet e diskriminimit për shkak të gjendjes shoqërore, pasi ankuesit nuk i është bërë ndonjë trajtim i ndryshëm nga ai i klientëve të tjerë, por në përmbushje të detyrimeve ligjore për ushtrimin e vigjilencës së zgjeruar, banka ka pranuar aplikimin dhe paraqitjen e dokumentave dhe ka bërë vlerësimin përkatës, mbi bazën e të cilit ka marrë vendimin për refuzimin e hapjes së llogarisë. Ankuesit nuk i është refuzuar *apriori*, çelja e llogarisë bankare.

Ankuesi është trajtuar njësoj si të gjithë klientët e tjerë të Bankës dhe i është nënshtruar të njëjtit proces vlerësimi të riskut, si klientët e tjerë. Pra, është respektuar parimi i barazisë në ofrimin e

shërbimeve bankare. Vlerësimi i kryer nga ana e Bankës, nuk është bazuar në kritere subjektive, por është bazuar në të dhëna objektive të cilat reflektojnë një risk të shtuar në procesin e parandalimit të pastrimit të parave. Në të njëjtën mënyrë, Banka ka refuzuar hapjen e llogarive edhe në raste të tjera kur nuk janë përmbushur standartet e kërkuara nga legjislacioni vendas si dhe politikat e grupit bankar, pjesë e të cilit është Banka.

Gjatë dy viteve të fundit, Banka ka refuzuar hapjen e llogarive bankare për 124 subjekte, të ndara sipas kategorive vijuese: 88 individë, 21 shoqëri tregtare sh.p.k, 12 persona fizikë tregtarë, 2 organizata jofitimprurëse (OJF) dhe 1 institucion financiar. Këto të dhëna tregojnë se nuk kemi të bëjmë me diskriminim të ankuesit, por për kryerjen e një procesi vlerësimi bazuar në procedurat e bankës, në përfundim të të cilit është konkluduar për mosmiratimin e kërkesës për hapjen e llogarisë. Ankuesi është trajtuar njësoj si të gjithë klientët e tjerë, që përfshihen në kategorinë e “personave të ekspozuar politikisht”¹⁰ (PEP).

Nga ankesa e paraqitur, nuk kuptohet se cili është shkaku diskriminues që pretendohet dhe i cili konsiderohet “grup i veçantë”, të cilit i përket ankuesi. Referuar pretendimit të ankuesit se është diskriminuar nga Banka, në cilësinë e tij si ish-gjyqtar, Banka deklaroi se ajo ka trajtuar kategorinë e klientëve ish gjyqtarë/prokurorë të shkarkuar gjatë procesit të vlerësimit kalimtar, të cilët i përkasin kategorisë së klientëve PEP, në mënyrë të njëjtë si gjithë klientët e tjerë PEP (persona të ekspozuar politikisht), duke bërë monitorimin dhe vlerësimin e tyre në përputhje me kërkesat e ligjit, si dhe rregulloret dhe procedurat e saj të brendshme. Në cilësinë e provës, Banka ka depozituar një listë me 101 klientë të saj, të cilët janë ish prokurorë dhe ish gjyqtarë të shkarkuar gjatë procesit të vlerësimit kalimtar.

Sikurse edhe në rastin e paraqitjes së një kërkesë për hapje llogarie, ashtu edhe në rastin e ekzistencës së një marrëdhënie juridike me Bankën, vlerësimi i klientëve nuk është bërë në mënyrë të paragjykuar, siç pretendohet nga ankuesi, por është bërë në mënyrë individuale për secilin prej klientëve. Banka nuk ka përjashtuar automatikisht këto klientë, por në zbatim të detyrimeve ligjore dhe procedurave të saj të brendshme, ka vlerësuar të dhënat e klientit dhe ka marrë vendimet përkatëse:

- Të vijojë marrëdhëniet e biznesit, duke i ofruar të gjitha produktet dhe shërbimet;
- Të vijojë marrëdhëniet e biznesit duke u kufizuar vetëm në një grup produktesh dhe shërbimesh, si psh: jo produkte me rrisht të lartë;
- Të rishikojë marrëdhëniet e biznesit;
- Të mos çelë marrëdhënie biznesi;
- Të mos zgjerojë marrëdhëniet e biznesit me subjekte të lidhura, por të qëndrojë dhe të vijojë ato marrëdhënie ekzistuese të cilat kanë një kontratë aktive;
- Të çelë marrëdhënie biznesi të reja, duke vendosur kushte specifike bazuar në oreksin e riskut, gjithmonë nëse janë në një linjë edhe me strategjinë e biznesit;

¹⁰ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën PEP.

Gjatë ecures së marrëdhënies me 101 klientët PEP, të kategorisë ish-prokurorë/gjyqtarë të shkarkuar në procesin e vlerësimit kalimtar, Banka ka vendosur të vazhdojë marrëdhënie biznesi me 57 prej tyre, ndërkohë që për 44 prej tyre është zgjidhur kontrata. Në shumë raste kontrata është zgjidhur nga Banka, ndërkohë që në disa raste është kërkuar edhe nga vetë klienti. Në rastin e ankuesit, Banka ka vlerësuar se ankuesi mund të vazhdojë të ketë llogari personale, por nuk mund të zgjerojë marrëdhënien e biznesit edhe me llogaritë si person fizik tregtar.

Në një rast të ngjashëm, Banka ka vendosur të çelë llogari rrjedhëse për subjektin me NIPT xxxxxxxxxxx, i cili ka të njëjtin status si ankuesi. Hapja e llogarisë është bërë në datë 12.10.2020, në degën Elbasan. Ky fakt tregon se, Banka nuk ka kryer veprime që diskriminojnë ankuesin, apo personat që kanë të njëjtin status me të, dhe konfirmon gjithashtu procedurën që ndiqet nga ana e Bankës, e cila në vendimmarrjen e saj bazohet në vlerësimin e profilit të riskut për çdo klientë të veçantë. Në praktikën e punës së Bankës, ka raste kur është vendosur refuzimi i hapjes së llogarisë, ashtu edhe raste kur është vendosur hapja e llogarisë.

Në vlerësimin e Bankës, arsyet pse në një rast është vendosur hapja e llogarisë dhe në një rast tjetër jo, nuk janë objekt i shqyrtimit të ankesës paraqitur prej ankuesit, i cili pretendon se banka e ka diskriminuar atë, në cilësinë e tij si ish-gjyqtar. Fakti tregon se Banka i ka bërë vlerësimet në bazë të profilit të riskut për secilin klient në veçanti dhe jo në grup, gjë që do të thotë se nuk ndodhemi një rasti diskriminimi. Refuzimi për të hapur llogari apo vendimi i Bankës për të mos vazhduar një marrëdhënie biznesi me një klient PEP, apo një ish-gjyqtar/prokuror, nuk është i paragjykuar dhe nuk bazohet në kritere subjektive, por është rezultat i një vlerësimi që bëhet në përputhje me kriteret e ligjit dhe rregulloret përkatëse të bankës.

Fakti që Banka në varësi të analizës dhe vlerësimit që bën, në disa raste vendos hapjen e llogarive dhe në disa të tjera jo; apo kur në disa raste vendos vazhdimin e marrëdhënies së biznesit dhe në disa raste të tjera jo, tregon se vendimmarrja e Bankës bazohet në kërkesat e ligjit si dhe në rregullat dhe procedurat e saj të brendshme, dhe nuk ka asnjë paragjykim për persona të veçantë, apo për grupe të caktuara shoqërore. Do të mjaftonin shembujt si më sipër, sipas të cilëve rezultojnë se Banka ka bërë analizë të të dhënave për secilin klientë dhe më pas ka marrë vendimin përkatës, që është i ndryshëm për klientë të ndryshëm që përfshihen në të njëjtën kategori PEP- ish gjyqtarë/prokurorë të shkarkuar nga detyra, për të arritur në përfundimin se ankesa është e pabazuar.

Së treti: Lidhur me procedurën që ndiqet nga Banka, për vlerësimin e riskut të klientëve.

Referuar ligjit nr. 9917 datë 15.09.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, (me ndryshime)¹¹, akteve nënligjore që janë nxjerrë në zbatim të tij, si dhe Rregullores së Bankës mbi “Parandalimin e pastrimit të parave, financimin kundër terrorizmit, sanksionet

¹¹ Në vijim ligji do t'i referohemi me shkurtesën ligji nr.9917/2008.

*financiare, materialet e luftës, lojrat e fatit dhe energjia bërthamore*¹², Banka është e detyruar të ushtrojë masat e viigjilencës së duhur dhe të zgjeruar ndaj klientëve.

Vigjilenca e zgjeruar ushtrohet për të verifikuar dhe për të vlerësuar identitetin e klientit, për të kuptuar dhe testuar profilin e klientit, të biznesit dhe veprimtarisë së tij, për të identifikuar informacionet me rëndësi për të vlerësuar rrezikun e mundshëm për pastrim parash, në mbështetje të vendimeve që synojnë mbrojtjen nga rreziqet financiare, rregullatore apo reputacionale si dhe përshtatjen ndaj kërkesave ligjore.

Me qëllim që të sigurohet implementimi i standarteve europiane për parandalimin e pastrimit të parave, grupi bankar Raiffeisen, pjesë e të cilit është Banka, ka investuar në sistemin e bankave pjesë e këtij grupi bankar, për automatizimin e proceseve që lidhen me vlerësimin e riskut të klientit. Në këtë mënyrë sigurohet që vlerësimi fillestar i riskut të bëhet në mënyrë automatike, gjë që siguron edhe shmangien e vlerësimeve subjektive të rasteve.

Çdo degë e Bankës ku mund të bëhet një aplikim për hapje llogarie, mbasi kryhet procesi i kontrollit automatik në lidhje me të dhënat e klientit, stafit të degës së bankës që ka kryer regjistrimin e aplikantit, i shfaqet një mesazh nëpërmjet të cilit merr dijeni se bëhet fjalë për një klient me risk të lartë dhe se për këtë arsye duhet të presin udhëzimet e mëtejshme. Në vijim të këtij procesi, në mënyrë automatike nga sistemi bëhet vlerësimi i riskut të klientit si dhe kryehet filtrimi i të dhënave kundrejt listave lokale dhe të huaja të personave PEP, si dhe të gjitha listat ndërkombëtare të sanksioneve dhe personave të listuar.

Një ndër platformat e njohura ndërkombëtare që shërben për marrjen e informacionit është *World Check* (Reduktimi i riskut nëpërmjet inteligjencës), e cila ndihmon institucionet financiare për mbrojtjen nga rreziqet reputacionale, financiare dhe rregullatore, nëpërmjet monitorimit të informacionit për klientët me risk të lartë.

Në zbatim të kërkesave të ligjit, për PEP, Banka detyrohet të marrë edhe miratimin e drejtuesve të lartë për vendosjen e marrëdhënieve të biznesit me këtë kategori klientësh, që sipas përcaktimeve të ligjit konsiderohen me risk të lartë. Vendimet që merren nga ana e Bankës në këto raste, synojnë në radhë të parë mbrojtjen e Bankës kundrejt ekspozimeve që mund t'i vijnë asaj nga klientët me risk të lartë.

Një nga kriteret mbi të cilat bëhet vlerësimi i bankës nga autoritetet europiane dhe austriake, meqënëse Banka është pjesë e grupit Raiffeisen, sipas metodologjisë MLRA (Analiza e riskut për pastrimin e parave), është përqindja e klientëve me risk të lartë, në raport me totalin e klientëve. Sa më i lartë të jetë ky koeficient, aq më me risk konsiderohet Banka. Ky kriter përdoret edhe nga Banka, në vlerësimin që i bëhet bankës nga bankat korrespondente dhe ndërmjetëse.

Sipas ekstraktit të raportit vjetor të vlerësimit të riskut për pastrim parash 2018-2019 (MLRA) për Bankën, rezulton se ka një trend në rritje të përqindjes së klientëve me risk të lartë, në raport me totalin e klientëve. Koeficienti për vitin 2018 ka qenë 1.38, ndërsa në vitin 2019 ka shkuar 1.77. Në

¹² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Rregullorja e Bankës.

rritjen e këtij treguesi, ndikim të veçantë ka patur rritja e klientëve PEP, që janë individë ose subjekte të lidhura me to. Kjo ka imponuar marrjen e masave për reduktimin e riskut, si dhe për menaxhimin në vazhdimësi të riskut të mbetur, në përputhje me metodologjinë dhe procedurat përkatëse.

Vlerësimi i riskut është i lidhur edhe me konceptin e “*risk appetite*”, që përkufizohet si shuma e rrezikut që një organizatë është e gatshme të ndërmarrë, për të përmbushur objektivat e saj. Për këtë arsye, Banka tregon kujdes të veçantë në vlerësimin e riskut të klientëve dhe miratimin e hapjes së llogarive, si për klientët individë dhe organizatat jofitimprurëse, ashtu edhe për klientët që ushtrojnë aktivitete biznesi. Pra synimi është që banka të ekspozohet ndaj rreziqeve, në përputhje me procedurat, objektivat dhe strategjitë e saj. Gjithashtu, në vlerësimin që bën banka për çeljen e llogarive për personat me risk të lartë, mbahet parasysh edhe fakti se numri i lartë i klientëve me risk të lartë, mund të passjellë rreziqe për bankën, për sa i përket marrëdhënieve me bankat korrespondente dhe bankat ndërmjetëse, nëpërmjet të cilave kryen transaksionet e pagesave me jashtë.

Së katërti: Vlerësimi i riskut në rastin e ankuesit.

Për ankuesin, është bërë verifikimi paraprak i të dhënave, nëpërmjet platformës ndërkombëtare *World Check* (Reducing Risk Throught Intelligence). Nga këto të dhëna, rezulton se në emër të ankuesit është raportuar: *Janar 2019- shkarkuar nga detyra me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit pasi nuk ka qenë në gjendje të justifikojë pasuritë e fituara.*

Referuar të dhënave për ankuesin, vlerësimi i riskut ka rezultuar i nivelit 3, që është kategoria më e lartë e riskut për klientët e bankës. Ky nivel i lartë risku, rezulton i tillë për shkak të disa elementëve:

- Rekordet në lidhje me shkarkimin e tij nga detyra me vendim të KPK dhe KPA;
- Lidhje me Person të Ekspozuar Politikisht;
- Lloji i aktivitetit që ka kërkuar të kryejë subjekti, në fushën e “Avokatisë”

Pas verifikimeve të kryera nga Banka, si dhe të dhënave të bëra publike, ka rezultuar se në bazë të vendimit nr.95, datë 08.01.2019 të KPK, ankuesi, ish gjyqtar/kryetar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është shkarkuar nga detyra, pasi subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë. KPA, me vendimin nr.6, datë 18.06.2020 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të KPK për shkarkimin nga detyra të ankuesit.

Shkalla e lartë e riskut lidhet gjithashtu edhe me aktivitetin që ushtron aktualisht ankuesi. Sipas Raportit “*Masa kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*” për Shqipërinë, të vitit 2019, Shqipëria renditet në “zonën gri” (grey list) dhe ndër të tjera është kërkuar që të përdoren mekanizma efektivë në lidhje me kontrollin e profesioneve të lira. Kjo është edhe arsyeja që aktiviteti i avokatëve, konsiderohet si aktivitet me risk të lartë, për sa i përket masave që duhet të ndërmerren edhe nga bankat, për parandalimin e pastrimit të parave

Pasi Banka ka bërë vlerësimet përkatëse të rastit, nga ana e organeve vendimmarrëse të bankës është konkluduar se lidhja e synuar e biznesit me këtë klient, nuk është në kuadër të riskut që është e gatshme të marrë përsipër Banka, në përputhje me standartet që ajo aplikon për vlerësimin e riskut. Për këtë arsye, Banka ka refuzuar hapjen e llogarisë rrjedhëse për ankuesin, si subjekt tregtar, ndërkohë që ai vazhdon të ketë marrëdhënie me Bankën pasi ka llogari si individ.

Edhe fakti që ankuesi vazhdon të ketë marrëdhënie me Bankën, pasi nuk është vendosur mbyllja e llogarive personale, tregon se në vendimarrjen e saj Banka nuk niset nga paragjykimi kundrejt personit dhe statusit të tij, por bazohet në rregulla dhe procedurat që ajo ka për vlerësimin e riskut dhe ushtrimin e vigjilencës së duhur/zgjeruar.

Sa më sipër, Banka nuk e ka diskriminuar ankuesin, në asnjë hap të procesit dhe vendimit të marrë prej saj për refuzimin për të hyrë në marrëdhënie biznesi me ankuesin, i cili kishte kërkuar hapjen e llogarisë për aktivitetin e tij si person fizik tregtar.

II/B Prapësimet e ankuesit lidhur me qëndrimin e Bankës.

Pretendimet se Banka, referuar ligjit nr.9917/2008, duhet të zbatojë masat e vigjilencës për të vlerësuar identitetin e klientit dhe për të kuptuar dhe testuar profilin e klientit të biznesit dhe veprimtarisë së tij, për të identifikuar informacione me rëndësi, për të verifikuar rrezikun e mundshëm për pastrim parash, janë parashtrime të cilat paraqiten në formën e diskriminimit, kur thonë se duhet të vlerësohet identiteti i klientit.

Ankuesi deklaron se, ka qenë drejtues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nga 30 Qershori 2008 deri në datën 18.06.2020, kur është shkarkuar nga detyra e gjyqtarit dhe për rrjedhojë është klient i njohur nga Banka, pasi si drejtues i gjykatës ka lidhur kontratë për llogarinë e pagës së institucionit, dhe depozitat familjare. Për këtë arsye, pretendimet se ankuesi është klient i panjohur për Bankën, nuk qëndrojnë.

Pretendimet e Bankës se ankuesi është klient që nuk plotëson kërkesat e identifikimit dhe të vigjilencës, janë vetëm citime të ligjit dhe nuk ka asnjë provë ose indicie që të provojë kërkesat për vigjilencë. Banka duhet të paktën të përmendte se ku qëndron paaftësia e ankuesit si klient, pasi ai në çdo rast në marrëdhëniet me Bankën ka qenë korrekt dhe nuk ka patur asnjë dyshim për parashtrimet që ngre Banka për pastrim parash, të cilat ankuesi i konsideron shprehje fyese dhe diskriminuese.

Rregullorja e Bankës së Shqipërisë, e miratuar me vendimin nr.44, datë 10.6.2009 të Këshillit Mbikëqyrës, nuk është e zbatueshme vetëm për këtë Bankë, por për të gjitha bankat. Ankuesi është paraqitur për çeljen e të njëjtës llogari bankare pranë Fibank sh.a, e cila brenda 2 ditëve i ka çelur llogarinë bankare.

Ankuesi deklaron se nuk është më person i ekspozuar dhe aq më shumë person i ekspozuar politikisht, sikundër parashtrohet nga Banka. Ankuesi ka kërkuar çeljen e llogarisë bankare me qëllim ushtrimin e profesionit të lirë si avokat. Në rast se ankuesi nuk do të lejohej të ushtronte këtë profesion, si nuk do të ishte regjistruar si person i tatueshëm nga ana e Qendrës Kombëtare të

Biznesit. Po në rast se të gjitha bankat do të vepronin si Raiffaisen Bank sh.a, nuk do të çelnin llogari bankare, si mund të vepronte ankuesi për përmbushjen e detyrimeve të tilla si pagesa e TVSH? Sipas ankuesit, është shumë diskriminuese dhe për tu habitur fakti se, kur bëhet fjalë për depozita bankare dhe për kontrata që janë në interes të Bankës, ai konsiderohet klient i rregullt dhe plotëson kriteret që të hyrë në marrëdhënie bashkëpunimi me Bankën.

Në datën 05.08.2020, vetëm 7 ditë pas paraqitjes së kërkesës për çeljen e llogarisë së biznesit, Banka ka njoftuar dhe më pas midis palëve është lidhur kontrata “Urdhër për blerjen e kuotave në fondin e investimit ” për periudhën 05.08.2020 deri në 05.08.2021. Ankuesi gjithashtu deklaroi se, ai dhe familja e tij, kanë disa llogari bankare pranë Bankës (Depozitë bankare të kursimeve të familjes, llogari e pagës dhe depozitat bankare të kursimeve të fëmijëve). Banka aktualisht vazhdon të dërgojë me email, kërkesa dhe oferta, gjë e cila sipas ankuesit tregon se ai ka qenë dhe është klient i njohur prej saj.

Përgjigjen e Bankës në lidhje me ankesën e bërë, ankuesi deklaroi se e ka marrë në datën 28.09.2020, pas paraqitjes së ankesës pranë Komisionerit.

Ankuesi deklaroi se, në asnjë pjesë të vendimit nr.6, datë 18.06.2020 të KPA, nuk është përdorur shprehja “nuk provonte burimin e disa pasurive të tij”, pretenduar nga Banka.

Në asnjë nga dispozitat e ligjit Nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Aneksin e Kushtetutës, nuk parashikohet se subjekteve të shkarkuara nga *Vetingu*, u ndalohej çelja e llogarive bankare ose ndonjë kufizim tjetër, veç përjashtimit nga funksioni. Në këtë mënyrë ankuesi pretendon se është penguar nga Banka, duke e diskriminuar që të ushtroj në të njëjtën mënyrë me personat e tjerë që ushtrojnë aktivitetin e Avokatit.

II/B Prapësimet e Bankës, lidhur me kundërshtimet e ankuesit.

Sipas Bankës, nga argumentat e parashtruara nga ankuesi, del qartë se bëhet fjalë për një ankesë që nuk ka asnjë bazë ligjore, por që bëhet për ta vendosur Bankën me pa të drejtë, në pozitën e një pale që ka kryer veprime diskriminuese në dëm të ankuesit. Këtë e tregon fakti që ka paraqitur vetë ankuesi, duke deklaruar se brenda dy ditësh ka çelur llogari në një bankë tjetër të nivelit të dytë. Nëse ankuesi ka hapur një llogari bankare në një bankë tjetër, del fare qartë se pretendimi që është vendosur në pozita diskriminuese dhe poshtëruese në krahasim me klientët e tjerë, është një pretendim krejtësisht abuziv dhe pa asnjë bazë ligjore.

Procedura e njohjes së klientit nga ana e Bankës, nuk ka të bëjë thjesht dhe vetëm me njohjen ose jo të individit apo subjektit tregtar/juridik, por në kuptim të ligjit, procedura “Njihe Klientin tënd” nënkupton një sërë rregullash, të përdorura nga subjektet e ligjit nr.9917/2008, që kanë të bëjnë me politikën e pranimit e të identifikimit të klientit dhe administrimit të riskut të tyre. Për rrjedhojë pretendimet e ankuesit se është klient i njohur i Bankës, është pretendim i pabazuar dhe pa kuptim.

Ligji nr. 9917/2008, nuk bën fjalë për “paaftësi të klientit”, sikundër prapësohet nga ana e ankuesit, por për “paaftësi të bankës” për të ushtruar vigjilencën e duhur apo të zgjeruar.

Bankat janë të detyruara të respektojnë të njëjtin kuadër ligjor, por nga ana tjetër secila prej bankave ka procedurat dhe rregulloret e saj të brendshme, të cilat nuk janë të njëjtoja për secilën bankë. Për këtë arsye, Banka e konsideron të pabazuar pretendimin e ankuesit se diskriminimi konsiderohet i vërtetuar me faktin se atij i është çelur llogaria bankare pranë një banke tjetër, brenda 2 ditëve.

Pretendimi i ankuesit se nuk është më person i ekspozuar politikisht, pasi aktualisht ushtron aktivitet privat, është sipas Bankës i pabazuar pasi, në zbatim të ligjit kjo kategori personash konsiderohen “persona të ekspozuar politikisht” deri në 3 vjet pas largimit nga funksioni.

Fakti i pretenduar nga ankuesi se, Banka ka vazhduar të dërgojë në adresën e tij njoftime, jo vetëm që nuk provojnë pretendimet për diskriminim të parashtruara nga ankuesi, por përkundrazi sipas Bankës tregojnë se ajo ka vazhduar në mënyrë korrekte marrëdhënien me ankuesin si klient me llogari personale, por ka vendosur të mos çelë llogari sipas kërkesës së tij për aktivitetin tregtar.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se është njoftuar nga Banka dhe ka marrë përgjigjen me shkrim në datën 28.09.2020, Banka sqaron se shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme, të Bankës, është protokolluar me nr.18380, datë 21.08.2020 dhe i është dërguar degës së Bankës në Sarandë, në mënyrë që t’ia dorëzonte ankuesit. Ky i fundit sipas Bankës është kontaktuar me telefon nga ana e drejtores së degës së bankës, i është bërë me dije përmbajtja e përgjigjes dhe i është kërkuar të paraqitet në bankë për të marrë zarfin me përgjigjen. Ankuesi është paraqitur fizikisht për të marrë përgjigjen në datën 28.09.2020. Sipas Bankës një fakt i tillë, nuk ka lidhje me diskriminimin, në kuptim të të drejtave që mbrohen nga ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Banka prapëson si të pabazuar pretendimin se ajo ka penguar, duke diskriminuar ankuesin që të ushtrojë në të njëjtën mënyrë me personat e tjerë që ushtrojnë aktivitetin e avokatit, pasi ankuesi vazhdon në mënyrë të rregullt dhe normale aktivitetin e tij si avokat.

II/C Opinioni i Bankës së Shqipërisë.

Komisioneri kërkoi nga Banka e Shqipërisë, në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës për subjektet bankare, opinion për çështjet e mëposhtme:

- A sjell në çdo rast ushtrimi i vigjilencës së duhur apo vigjilencës së zgjeruar, detyrimin e subjekteve bankare për të mos çelur llogarinë bankare, në kuadër të parandalimit dhe pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, apo ky detyrim për mos të çelur llogarinë, është i lidhur me faktin e paaftësisë së subjekteve bankare për të ushtruar vigjilencën e duhur ose vigjilencën e zgjeruar?
- Në cilat kushte vlerësohet se subjektet bankare janë të paafta për të ushtruar vigjilencën e duhur dhe vigjilencën e zgjeruar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar dhe Rregullores së Bankës së Shqipërisë nr.44, datë 10.06.2009 “Për miratimin e rregullores “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar?
- Në vlerësimin tuaj, a ka qenë Raiffeisen Bank sh.a e paaftë për të ushtruar vigjilencën e duhur ose vigjilencën e zgjeruar në rastin e mësipërm dhe për cilat arsye?

- A ka të drejtë subjekti bankar të refuzojë çeljen e llogarisë në kushte të tjera, përveç detyrimeve ligjore në kuadër të parandalimit të pastrimit të parave dhe fianncimit të terrorizmit? Nëse po, në cilat raste një subjekt bankar mund të refuzojë çeljen e llogarisë bankare apo banka ka diskrecion të plotë të vendosë ajo vetë nëse do të çelë ose jo llogarinë bankare?

Në opinionin e dërguar Banka e Shqipërisë parashtrori se: “... Neni 31, i ligjit nr.9662, datë 28.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar¹³, i jep pavarësi bankës në lidhje me administrimin dhe drejtimin e saj. Në këto kushte mbetet në gjykimin e pavarur të bankës që mbështetur në politikat dhe aktet e brendshme rregullatore të hyjë në marrëdhënie biznesi ose jo, të vazhdojë ose ndërpresë këtë marrëdhënie me klientët.”

II/D Qëndrimi i ankuesit, në lidhje me përgjigjen e Bankës së Shqipërisë.

Sipas ankuesit, interpretimi i nenit 31, të ligjit nr. 9662/2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga ana e Bankës së Shqipërisë nuk është i bazuar dhe se ky nen nuk parashikon interpretimet e Bankës së Shqipërisë. Ankuesi deklaron se, ai nuk gjendet në kushtet e parashikuara nga ky nen, pasi nuk ka ndërhyrë në mënyrë të paautorizuar, për të ndikuar në administrimin dhe drejtimin e bankës së huaj, por ka kërkuar çelje të llogarisë bankare pranë Bankës.

II/E Qëndrimi i Bankës në lidhje me përgjigjen e Bankës së Shqipërisë.

Sipas Bankës, përgjigja e Bankës së Shqipërisë, sqaron pavarësinë e bankës në lidhje me vendimarrjen e saj, nëse duhet të hyjë në marrëdhënie biznesi ose jo, të vazhdojë ose të ndërpresë këtë marrëdhënie me klientët.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A.Lidhur me diferencën në trajtim të cilës i është nënshtruar ankuesi.

Bazuar në aktet e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, rezultoi e provuar se:

Ankuesi ka ushtruar funksionin si gjyqtar dhe ka qenë me detyrë Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Me vendimin nr. 95, datë 08.01.2019, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ka vendosur shkarkimin e ankuesit nga kjo detyrë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Kolegji i Posaçëm i Apelit me vendimin nr. 6, datë 18.06.2020. Aktualisht, ankuesi ushtron profesionin e avokatit, pranë Dhomës së Avokatisë Sarandë, i pajisur me Liçencë Nr. 9796 dhe me Nipt xxxxxxxxxxxx.

¹³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën ligji nr. 9662/2006, i ndryshuar.

Në datë 29.07.2020, ankuesi është paraqitur pranë Degës Raiffeisen Bank sh.a, Sarandë dhe ka kërkuar çeljen e një llogarie rrjedhëse për llogari të tij, në cilësinë e personit fizik (PF) me qëllim ushtrimin e aktivitetit privat, si avokat.

Referuar deklarimeve të ankuesit, ai në datën 04.08.2020, pasi ishte paraqitur pranë degës së Bankës në Sarandë, punonjësit e kanë informuar gojarisht, se atij nuk mund t'i çelet llogaria bankare si biznes për arsye teknike. Në datën 09.08.2020, ankuesi ka paraqitur një kërkesë me anë të së cilës i kërkon Bankës që t'i kthehet një përgjigje më shkrim lidhur me arsyet për të cilat nuk i është çelur llogaria bankare e kërkuar për ushtrimin e aktivitetit privat si avokat.

Pasi ka paraqitur kërkesën e mësipërme, në datën 13.08.2020, ankuesi është njoftuar me sms, nga Banka se ankesa ishte marrë në dorëzim dhe se do të kontaktohej pasi të ishin kryer të gjitha verifikimet e nevojshme në lidhje me rastin e tij. Duke mos patur asnjë përgjigje ka ana e Bankës, ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit, ankesën nr.101 regj, datë 22.09.2020, në të cilën pretendon se është diskriminuar nga ana e Bankës, duke i'u refuzuar çelja e llogarisë bankare për të ushtruar aktivitet privat si avokat, për shkak të gjëndjes së tij shoqërore, si ish gjyqtar.

Në nenin 3, pika 1, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: “1. **“Diskriminim”** është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”. Në mënyrë të posaçme ligji, parashikon mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, në Kreun IV të tij. Ligji, në nenin 20, ndalon çdo person fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me ose pa pagesë, që të diskriminojë një person që kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato, duke parashikuar në pikën 1, të këtij neni se : “ 1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”

Bazuar në nenin 20/2/e, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se ndalimi i diskriminimit në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve, parashikuar nga neni 1, i ligjit, zbatohet veçanërisht, por jo vetëm, në lidhje me, **shërbimet e bankës** dhe mundësi për të siguruar grante, huadhënie, depozita bankare ose financim.

Banka është një person juridik privat, e cila ushtron veprimtari në fushën bankare. Në ushtrim të aktivitetit të saj tregtar në fushën përkatëse për të cilin është liçensuar, Banka ofron shërbime të ndryshme bankare, të hapura për publikun e gjerë. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se jemi në kushtet kur Banka, në cilësinë e një personi juridik që ofron shërbime bankare për publikun,

është e detyruar të zbatojë ndalimin e diskriminimit në fushën e të mirave dhe shërbimeve sipas parashikimeve të mësipërme.

Në nenin 3, pika 2, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, parashikohet se: *“Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.”*

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar në fushën e të mirave dhe shërbimeve, duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesi është trajtuar ndryshe, në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme.
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme me të;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ankuesi, i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, duke i'u refuzuar ofrimi i shërbimit, sikundër në këtë rast refuzimi për t'i çelur ankuesit llogarinë bankare si biznes me qëllim ushtrimin e aktivitetit privat si avokat, nga ana e Bankës.

Të gjithë individët, persona fizikë ose juridikë gëzojnë lirinë kontraktuale, duke përfshirë lirinë për të zgjedhur partnerin kontraktual me të cilin dëshirojnë të kryejnë një transaksion ose të hyjnë në marrëdhënie biznesi.

Në rastin konkret kërkesa e paraqitur nga ankuesi për çeljen e llogarisë bankare si biznes, përbën një kërkesë për të hyrë në marrëdhënie kontraktuale me Bankën në cilësinë e ofruesit të shërbimit, një shërbim që ankuesi kërkon ta përdorë. Si të gjitha marrëdhëniet kontraktuale edhe në rastin konkret, kërkohet që palët të shprehin vullnetin e tyre për të hyrë ose jo në një marrëdhënie juridike. Një subjekt që ofron të mira dhe shërbime mund të ketë shumë arsye, qoftë edhe të natyrës subjektive, për zgjedhjen e palës/palëve me të cilët dëshiron të hyjë në marrëdhënie kontraktuale. Për sa kohë që përzgjedhja e klientit ose e partnerit më të cilin ofruesi i shërbimit dëshiron të hyjë në marrëdhënie nuk bazohet në një nga shkaqet e mbrojtura, ligji nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* nuk mund të ndalojë lirinë e subjekteve për të zgjedhur palën me të cilën dëshirojnë të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale. Kjo do të thotë se, për sa kohë që nuk provohet se shkak për refuzimin e ofrimit të shërbimit, është një nga shkaqet e mbrojtura, atëherë refuzimi për çeljen e llogarisë bankare nga ana e Bankës, nuk mund të përbëjë *apriori*, një veprim diskriminues, në kuptim të ligjit.

Ankuesi, për shkak të funksionit që ka ushtruar si gjyqtar dhe Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të nenit 3, të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, ka qenë subjekt i detyruar të bëjë deklarin e pasurisë së tij. Subjektet e detyruar të deklarojnë pasurinë sipas këtij ligji, bazuar në nenin 10, të ligjit nr. 9917/2018, konsiderohen “Persona të ekspozuar politikisht”. Bazuar në këtë dispozitë ligjore, kjo kategori personash, përfshirë edhe ankuesin, konsiderohen “persona të ekspozuar politikisht” deri në 3 vite pas largimit nga funksioni.

Ankuesi për shkak të detyrës që ka ushtruar si gjyqtar dhe Kryetar Gjykate, ka qenë subjekt rivlerësimi, bazuar në ligjin nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Organet e krijuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit të kësaj kategori funksionarësh, KPK dhe KPA kanë vendosur shkarkimin e ankuesit nga detyra dhe vendimarrja e tyre është bërë e formës së prerë në datë 18.06.2020.

Sa më sipër rezulton se, ankuesi konsiderohet person i ekspozuar politikisht, në kuptim të ligjit nr.9917/2008, të ndryshuar, deri në 3 vite pas largimit nga funksioni, largim i cili rezulton të ketë ndodhur në datën 18.06.2020. Për rrjedhojë, pretendimi i ankuesit se nuk përfshihet në kategorinë e personave politikisht të ekspozuar, në kuptim të ligjit, është i pabazuar.

Bazuar në nenin 3, të ligjit nr. 9917/2008, të ndryshuar, bankat janë ndër subjektet që i nënshtrohen këtij ligji. Qëllimi i ligjit nr. 9917/2008, i ndryshuar, është të parandalojë pastrimin e parave dhe produkteve që burojnë nga veprat penale, si dhe parandalimi i financimit të terrorizmit. Për realizimin e qëllimit të tij, ligji ka vendosur ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij ligji detyrime të ndryshme ndër të tjera detyrimin për të ushtruar vigjilencën e zgjeruar.

Sipas nenit 7, të ligjit nr. 9917/2008, të ndryshuar parashikohet se: “1. Vigjilenca e zgjeruar duhet të përfshijë masa shtesë, përveç atyre të parashikuara për vigjilencën e duhur, për marrëdhëniet e biznesit, klientët apo transaksionet me rrezik të lartë. Për zvogëlimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, krahas kategorive të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, subjektet përcaktojnë kategori të tjera marrëdhëniesh biznesi, klientësh dhe transaksionesh, të vlerësuara me rrezik të lartë dhe ndaj të cilave duhet të zbatohen masat e vigjilencës së zgjeruar. 2. Për zbatimin e vigjilencës së zgjeruar ndaj klientëve, subjektet duhet të kërkojnë praninë fizike të klientëve dhe të përfaqësuesve të tyre, para se të vendosin një marrëdhënie biznesi. 3. Kur subjektet janë të paafta që të plotësojnë detyrimet për vigjilencën e zgjeruar ndaj klientit, ato duhet të zbatojnë masat e parashikuara në pikën 2, të nenit 4/1, të këtij ligji.”

Bazuar në pikën 2, germa “a”, të nenit 4/1, të po këtij ligji, parashikohet se: “2. Kur subjektet janë të paafta që të plotësojnë detyrimet për vigjilencën e duhur ndaj klientit, sipas këtij neni dhe neneve 4, 4/1 e 5 të këtij ligji, duhet: a) të mos hapin llogari, të mos kryejnë transaksione dhe të mos fillojnë marrëdhënie biznesi;.....”

Ligji nr. 9917/2008, i ndryshuar ka vendosur mbi subjektet e detyruar sipas këtij ligji, detyrimin për të ushtruar vigjilencën e zgjeruar për kategorinë e klientëve që përfshihen në kategorinë e personave politikisht të ekspozuar (PEP). Konkretisht në nenin 8, të këtij ligji parashikohet se: *“1. Për personat e ekspozuar politikisht, subjektet duhet: a) të hartojnë dhe të zbatojnë sisteme efektive të menaxhimit të riskut për të përcaktuar nëse një klient ekzistues apo potencial ose pronari përfitues është një person i ekspozuar politikisht; b) të marrin miratimin e drejtuesve të lartë për vendosjen e marrëdhënieve të biznesit me personat e ekspozuar politikisht; c) të kërkojnë dhe të marrin miratimin e drejtuesve të lartë për vazhdimin e marrëdhënies së biznesit, në rastet kur marrëdhënia e biznesit me klientin është vendosur dhe subjekti konstaton që klienti apo pronari përfitues është bërë ose bëhet më pas person i ekspozuar politikisht; ç) të marrin masa të arsyeshme për të kuptuar burimin e pasurisë dhe të fondeve të klientëve e të pronarëve përfitues, të identifikuar si persona të ekspozuar politikisht. d) të marrin masat për të verifikuar nëse përfituesit apo pronarët përfitues në policat e sigurimit të jetës janë persona të ekspozuar politikisht, jo më vonë se në momentin e pagesës. Kur identifikohen rreziqe të larta, njoftohen drejtuesit e lartë përpara kryerjes së pagesës, kryhet verifikim i hollësishëm i marrëdhënies së biznesit me mbajtësin e policës, si dhe konsiderohet raportimi i aktivitetit të dyshimtë. 2. Në rastet kur subjektet kanë një marrëdhënie biznesi me personat e ekspozuar politikisht, ata duhet të mbikëqyrin me vigjilencë të zgjeruar këtë marrëdhënie.”*

Banka, është një subjekt që liçenohet dhe ushtron veprimtarinë bazuar në ligjin nr. 9662/2006 *“Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar dhe mbikëqyret gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj, nga Banka e Shqipërisë. Në zbatim të ligji nr. 9662/2006, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9917/2008, të ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me vendimin nr.44, datë 10.06.2009, ka miratuar Rregulloren *“Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”*¹⁴, e cila ka pësuar ndër vite disa ndryshime.

Në Rregulloren e Bankës së Shqipërisë *“Për parandalimin e pastrimit të parave”*, parashikohet detyrimi i subjekteve bankare për marrjen e masave të vigjilencës së zgjeruar sipas parashikimeve të ligjit nr. 9917/2008, aktet nënligjore të dala në zbatim të tij si dhe parashikimet e kësaj rregulloreje. Sipas kësaj rregulloreje subjektet janë të detyruara të bëjnë vlerësimin e riskut që rrjedh nga ekspozimi ndaj pastrimit të parave. Ky vlerësim sipas rregullores duhet të bëhet duke përcaktuar faktorët e riskut dhe më pas duke përcaktuar kategoritë e faktorëve të riskut.

Referuar Aneksit I, të kësaj rregulloreje, i cili është një udhëzues për bankat, për matjen e rrezikut nga pastrimi i parave, **me faktorë rreziku** do të kuptojmë, bashkësinë/grupin e kategorive të klientëve, produkteve dhe shërbimeve/transaksioneve, marrëdhënieve të biznesit, si dhe zonës gjeografike të përcaktuar nga burime të besueshme informacioni si grup kategorish gjerësisht të pranuar për të vlerësuar rrezikun, ndërsa me **kategori të faktorit të rrezikut** do të kuptojmë, llojet e klientëve, me të cilët subjekti ka hyrë në marrëdhënie biznesi, llojet e produkteve dhe të shërbimeve që subjekti u ofron klientëve, llojet e transaksioneve dhe marrëdhënieve të biznesit si

¹⁴ Në vijim do t'i referohemi me shkurtësën, Rregullorja e Bankës së Shqipërisë.

dhe zona gjeografike prej të cilës klientët janë (prejardhja/vendndodhja) ose kanë marrëdhënie biznesi.

Në pjesën e III-të, të Aneksit I, të kësaj rregulloreje, parashikohet se: *“Subjektet konsiderojnë faktorë gjerësisht të pranuar (më të përdorur) të identifikimit dhe matjes së rrezikut, të cilët janë: rreziku gjeografik, rreziku i klientit, si dhe rreziku i produktit dhe shërbimeve/transaksioneve dhe marrëdhënieve të biznesit. Subjektet bazohen në këta tre faktorë, të cilët përbëjnë minimalisht faktorët që shërbejnë për matjen e rrezikut. Subjekte të ndryshme mund të aplikojnë peshë ponderimi të ndryshme për këta faktorë (individualisht apo në kombinim) në vlerësimin e rrezikut, në varësi të aktivitetit dhe rrethanave përkatëse. Rrjedhimisht, subjektet do të duhet të bëjnë përcaktimin e këtyre peshave dhe arsyetimin përkatës për madhësinë e peshave të zgjedhura / aplikuar. Këto peshë janë subjekt i vlerësimit gjatë kontrolleve në vend, në përputhje me profilin, strategjinë si dhe vizionin e subjektit... **Të gjitha kategoritë e përcaktuara në kuadrin ligjor dhe udhëzimet përkatëse, të cilat kanalizohen në procesin e vigjilencës së zgjeruar, mbartin vlerën e rrezikut më të lartë pra koeficientët e ponderimit më të lartë.** Kjo nënkupton që rezultati i sistemit të ndërtuar nga subjekti duhet të kanalizojë automatikisht marrëdhënien e biznesit me klientin në kategorinë e Vigjilencës së Zgjeruar. Për shembull, në rastin që një PEP kryen një transaksion, marrëdhënia kanalizohet automatikisht në procesin e vigjilencës së zgjeruar dhe si rrjedhim, subjekti duhet të marrë të gjitha masat në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi.”* Në vijim kjo rregullore, përcakton se PEP, bëjnë pjesë në kategoritë e klientëve, veprimtaritë e të cilëve mund të jene tregues i nivelit të rrezikut më të lartë.

Ndërsa, për sa i përket, rrezikut të produkteve dhe shërbimeve/kategoritë e transaksioneve dhe marrëdhënieve të biznesit, rregullorja përcakton ndër të tjera se, kategoritë të cilat paraqesin një nivel të lartë rreziku janë edhe ato shërbime të identifikuar nga ana e autoriteteve kompetente ose burime të tjera të besueshme si potencialisht me rrezik të lartë.

Rezulton se Banka ka miratuar Rregulloren e saj mbi *“Parandalimin e Pastrimit të Parave, financimin kundër terrorizmit, sanksionet financiare, materialet e luftës, lojrat e fatit dhe energjia bërthamore”*. Referuar këtij akti të brendshëm rregullator të Bankës, rezulton se transaksionet apo bizneset e lidhura me PEP do të trajtohen me vigjilencë të zgjeruar. Në rregullore, Banka ka përcaktuar se me vigjilencë të zgjeruar do të trajtohen edhe marrëdhëniet e biznesit ose transaksionet me klientë të tjerë me rrezik të lartë, duke mos i bërë shteruese parashikimet në lidhje me kategorinë e klientëve me rrezik të lartë, që do të trajtohen me vigjilencë të zgjeruar. Sipas rregullores së saj të brendshme, Banka, do të konsiderojë me rrisht akoma më të lartë, ata klientë që janë nga zona gjeografike me rrisht të lartë, siç janë vendet/sistemet financiare të cilat nuk kanë sisteme të mjaftueshme për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit ose kur korrupsioni ose aktivitete të tjera kriminale janë të rëndësishme (sipas burimeve të besueshme siç janë vlerësimet reciproke, raportet e vlerësimit të hollësishëm ose raportet e publikuara). Banka duhet gjithashtu të sigurojë vlerësimin e riskut dhe menaxhimin e klientëve, marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve, për të përcaktuar ndër të tjera, nëse një klient, pronar përfitues është një PEP. Për këtë qëllim, referuar Rregullores së Brendshme të Bankës, rezulton se masat e

parashikuara, janë në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara nga neni 8, i ligjit nr. 9917/2008, i ndryshuar në lidhje me masat e vigjilencës së zgjeruar për klientët PEP. Edhe në Rregulloren e saj të Brendshme, Banka ka parashikuar të njëjtin përcaktim që bën ligji nr. 9917/2008, i ndryshuar, në lidhje me detyrimin e bankës për të mos çelur llogarinë në rastet kur ajo është në pamundësi për të zbatuar të gjitha detyrimet e vigjilencës së zgjeruar.

Megjithatë, bazuar në legjislacionin e cituar më sipër, rezulton se parashikimi ligjor në nenin 7, pika 3 dhe 4/1, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 9917/2008, të ndryshuar, për të mos çelur llogarinë bankare ose për të mos vendosur marrëdhënien e biznesit, në kushtet kur subjektet janë në pamundësi të përmbushin kërkesat e vigjilencës së zgjeruar, është një detyrim për bankën kur plotësohen kërkesat që përlligjin pamundësinë e ushtrimit të vigjilencës së zgjeruar, dhe jo një e drejtë për bankën për të përlligjur mosçeljen e llogarisë bankare.

Për rrjedhojë ajo që Komisioneri do të vlerësojë në këtë rast, është fakti nëse statusi i ankuesit si ish gjyqtar, i cili është shkarkuar nga detyra në kuadër të procesit të vetingut, ka shërbyer si shkak, për trajtimin e diferencuar dhe refuzimin për t’i çelur llogarinë bankare nga ana e Bankës.

Në qëndrimin e mbajtur nga Banka, kjo e fundit deklaron se vendimi për të mos çelur llogarinë bankare për ankuesin, është bazuar në disa elementë, dhe konkretisht në: Rekordet në lidhje me shkarkimin e tij nga detyra me vendim të KPK dhe KPA; Lidhje me Person të Ekspozuar Politikisht; Lloji i aktivitetit që ka kërkuar të kryejë subjekti, në fushën e “Avokatisë”.

Në vlerësimin e rriskut që Banka ka realizuar për rastin e ankuesit, bazuar në shpjegimet e dhëna prej saj, rezulton se në momentin që ankuesi ka paraqitur aplikimin për çeljen e llogarisë bankare si biznes për të ushtruar profesionin si avokat, banka shprehet se verifikimi paraprak që ajo ka realizuar ka qenë nëpërmjet platformës ndërkombëtare *World Check* (Reducing Risk Through Intelligence). Nga të dhënat e marra nga kjo platformë ka rezultuar informacioni se ankuesi është shkarkuar në 2019 me vendim të KPK, pasi nuk ka qenë në gjendje të justifikojë pasuritë e fituara.

Më pas nga verifikimet e kryera nga Banka, sipas të dhënave të bëra publike, ka rezultuar se me vendimin nr.95, datë 08.01.2019 të KPK ankuesi ishte shkarkuar nga detyra si Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, pasi subjekti kishte bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë. Ky vendim rezulton që jetë lënë në fuqi nga KPA me vendimin nr. 6, datë 18.06.2020.

Referuar Raportit “*Masat kundër pastrimit të parave dhe financimit kundër terrorizmit*”, për Shqipërinë, publikuar në dhjetor të vitit 2019, nga MONEYVAL¹⁵ (Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit), në faqen 10, të këtij raporti, konstatohet se ka patur masa të kufizuara për të monitoruar dhe kontrolluar profesionet

¹⁵ MONEYVAL, është një organ i përhershëm monitorues i Këshillit të Evropës, i ngarkuar me detyrën e vlerësimit të pajtueshmërisë me standartet kryesore ndërkombëtare standardet për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe efektivitetin e zbatimit të tyre, si dhe me detyrën e bërjes rekomandime për autoritetet kombëtare në lidhje me përmirësimet e nevojshme për të sistemet e tyre.

e lira, pjesë e të cilave është edhe avokatia, referuar Standardeve Ndërkombëtare Mbi Pastrimin e Parave, Luftimin dhe Financimin e Terrorizmit, të njohura si Rekomandimet FATF.¹⁶

MONEYVAL, është një organ i përhershëm monitorues i Këshillit të Evropës, i ngarkuar me detyrën e vlerësimit të pajtueshmërisë me standartet kryesore ndërkombëtare, standartet për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe efektivitetin e zbatimit të tyre, si dhe me detyrën e bërjes së rekomandimeve për autoritetet kombëtare në lidhje me përmirësimet e nevojshme për të sistemet e tyre.

Në Rregulloren e Bankës së Shqipërisë, përcaktohet se informacioni publik, i cili vihet gjerësisht në dispozicion nga organet e njohura dhe me reputacion, si psh Organizata e Kombeve të Bashkuara, FATF, Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Këshilli i Evropës, OFAC, Grupi Egmont, por jo vetëm, përbën burim të besueshëm informacioni.

Referuar Raportit Vjetor 2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, rezulton se ky institucion nga, Vlerësimi Kombëtar i Riskut i konkluduar në vitin 2019 edhe në kuadër të detyrimeve të përcaktuara në Planin e Veprimit të FATF, për daljen nga lista e vendeve në monitorim, ka realizuar ndër të tjera, analizën për keqpërdorimin apo përfshirjen në pastrim parash të profesioneve të lira (avokat, agjent i pasurive të paluajtshme, kontabilist i miratuar/auditues ligjor), duke e konsideruar aktivitetin e avokatisë, si një aktivitet të ekspozuar ndaj rrezikut.

Sa më sipër, Komisioneri gjen të bazuar pretendimet e Bankës, në lidhje me shkalla e lartë e riskut, për sa i përket llojit të aktivitetit që ka kërkuar të kryejë ankuesi, në fushën e avokatisë.

Për sa i përket pretendimeve të ankuesit se Banka nuk i ka kthyer përgjigje brenda afateve në lidhje me kërkesën me shkrim që ai ka depozituar në datën 09.08.2020, me anë të të cilës ka kërkuar të njihet me arsyet e refuzimit për çeljen e llogarisë, shkresa nr.18380 prot., datë 21.08.2020, e Drejtorisë së Përgjithshme të Bankës, nuk rezulton t'i jetë njoftuar ankuesit përpara datës 28.09.2020. Ankuesi kundërshtoi pretendimin se është njoftuar përpara kësaj date nga Banka, dhe kjo e fundit, nuk arriti të provojë pretendimet e saj se shkresa në fjalë i është komunikuar ankuesit përpara datës së pretenduar prej tij. Megjithatë këto konstatime në lidhje me vonesën në kthimin e përgjigjes, nuk përbëjnë aspekte që kanë të bëjnë me elementët e kërkuar për diskriminimin, në kuptim të ligjit.

Pavarësisht se fakti i shkarkimit nga detyra si gjytar i ankuesit, nuk ka qenë faktori i vetëm mbi bazën e të cilit Banka ka vendosur të mos çelë llogarinë bankare për ankuesin, rezulton se ky element ka qenë i rëndësishëm, në vendimmarrjen e Bankës. Duke mbajtur në konsideratë faktin se nuk rezultoi që Banka të ndodhej në kushtet e pamundësisë për të

¹⁶ Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF) është një organ ndërqeveritar i themeluar në vitin 1989 nga Ministrat e vendeve anëtare. Mandati i FATF është të përcaktojë standartet dhe të nxisë zbatimin efektiv të masave ligjore, rregullative dhe operacionale për luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe kërcënime të tjera që lidhen me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar.

ushtruar vigjilencën e zgjeruar, fakt ky që do ta legjitimonte Bankën në bazë të ligjit nr. 9917/2008, të ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore dhe rregulluese të brendshme të Bankës, për të mos çelur llogarinë bankare për ankuesin, Komisioneri arrin në përfundimin se ka patur një diferencë në trajtim bazuar në faktin që ankuesi është një ish gjyqtar i cili është shkarkuar në kuadër të procesit të rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

B. Shkakun e mbrojtur

Neni 1, i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili përcakton objektin e këtij ligji, shprehet se ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke përfshirë edhe shkakun e gjendjes shoqërore.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1 si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakun të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Komisioneri konstaton se, mungon një praktikë juridike në nivelin kombëtar ose ndërkombëtar, e cila do të ndihmonte për të kuptuar qartë se çfarë elementësh përfshihen në gjendjes shoqërore, për t’u konsideruar si shkak i mbrojtur në kuptim të ligjit.

Në rastin konkret ankuesi pretendon se është diskriminuar nga ana e Bankës, e cila ka refuzuar të çelë llogarinë bankare si biznes në fushën e avokatisë, për shkak të faktit se ai është shkarkuar nga detyra si gjyqtar, në kuadër të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Komisioneri vlerëson se statusi ose aspektet në lidhje me punësimin ose llojin e punës, aktual ose të ushtruar më parë, tregojnë për pozicionin e personit në shoqëri.

Gjatë shqyrtimit rezultoi e provuar se ankuesi ka ushtruar detyrën si Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, detyrë nga e cila është shkarkuar bazuar në vendimmarrjet e organeve të krijuara në kuadër të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Për këto arsye, Komisioneri vlerëson se diferencat në trajtim që bazohen në statusin ose aspektet në lidhje me punësimin ose llojin e punës, aktual ose të mëparshëm, do të konsiderohet si diferencë në trajtim që bazohet në gjendjen shoqërore, dhe sa më sipër rezulton se ankuesi ka të vërtetuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të gjendjes shoqërore.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë më pak të favorshëm me shkakun e mbrojtur

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë

shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se : *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “ Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”* (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese)

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, duke mos parashikuar një të drejtë të veçantë në lidhje aksesin në shërbime bankare, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në bazë të ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përliqur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”*.

Sa më sipër, rezultoi e provuar se, ankuesi ka patur një diferencë në trajtim bazuar në statusin e tij si ish gjyqtar, i cili është shkarkuar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Por, referuar standarteve të mësipërme, diskriminuese janë vetëm ato diferenca në trajtim të cilat nuk bazohen në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës. Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* dhe Kodi i Procedurave Administrative, i kanë transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës

është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se nuk ka trajtim të diferencuar, ose që ky trajtim nuk është diskriminues.

Bazuar në nenin 82, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë një të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹⁷

Duke ju rikthyer fakteve dhe rrethanave të ankesës në shqyrtim, rezulton se ankuesi ka patur një diferencë në trajtim, bazuar në statusin e tij si ish gjyqtar, i cili është shkarkuar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Në këto kushte dhe bazuar në barrën e provës për çështjet e diskriminimit, i takon Bankës të tregojë që kjo diferencë në trajtim mund të justifikohet. Siç është theksuar edhe më sipër, një justifikim i tillë duhet të jetë objektiv dhe i arsyeshëm ose, me fjalë të tjera, ai duhet të ndjekë një qëllim të ligjshëm dhe duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Banka parashtroi se, vendimi i saj për të mos çelur llogarinë bankare si biznes në fushën e avokatisë për ankuesin, është marrë në zbatim të detyrimeve ligjore që burojnë në kuadër të legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave. Bazuar në nenin 1, të ligjit nr. 9917/2008, të ndryshuar, qëllimi i këtij ligji është të parandalojë pastrimin e parave dhe të produkteve që burojnë nga veprat penale. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se parandalimi i pastrimit të parave dhe produkteve që burojnë nga veprat penale, përbën një qëllim të ligjshëm.

Në zbatim të detyrimeve që burojnë në kuadër të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave, Banka është e ekspozuar ndaj një rreziku të shtuar në rastin e personave PEP, sikundër është edhe ankuesi, të cilët ligji i konsideron me risk të lartë. Në këtë kontekst, Banka deklaroi se vendimet që merren prej saj në këto raste synojnë në radhë të parë mbrojtjen kundrejt ekspozimeve që mund t'i vijnë asaj nga klientët me risk të lartë dhe se ajo synon që të ekspozohet ndaj rreziqeve, në përputhje me procedurat, objektivat dhe strategjitë e saj.

¹⁷ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

Neni 31, i ligjit nr. 9662/2006, i ndryshuar, përcakton se: *“Banka dhe dega e bankës së huaj administrohen dhe drejtohen mbështetur në parimet e tregut të lirë dhe konkurrencës së ndershme. Asnjë subjekt apo person publik nuk duhet të ndërhyjë në mënyrë të paautorizuar për të ndikuar në administrimin dhe drejtimin e bankës ose degës së bankës së huaj, përveç rasteve të zbatimit të akteve nënligjore të Bankës së Shqipërisë, ekzekutimit të urdhrave të organeve gjyqësore ose kur një gjë e tillë parashikohet me ligj.”* Po në këtë ligj, në nenin 57 përcaktohet se : *“1. Banka siguron një nivel të mjaftueshëm kapitali në raport me veprimtaritë e lejuara që ushtron, shtrirjen e tyre, si dhe tërësinë e rreziqeve, ndaj të cilave banka ekspozohet. 2. Banka ose dega e bankës së huaj ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë që rreziku, ndaj të cilit ajo ekspozohet për veprimtari të veçanta apo për të gjithë veprimtarinë, të jetë brenda kufizimeve të vendosura në mënyrë individuale ose të konsoliduar, të përcaktuara në këtë ligj ose në akte nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë. 3. Banka ose dega e bankës së huaj, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, përmbush detyrimet e saj në kohën e duhur dhe në mënyrë të vazhdueshme. 4. Banka ose dega e bankës së huaj, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, përcakton kriteret dhe harton metodat e procedurat për identifikimin dhe monitorimin e të gjitha rreziqeve, në përputhje me aktet e brendshme rregullative të bankës ose degës së bankës së huaj, të miratuara nga këshilli drejtues i saj. 5. Banka ose dega e bankës së huaj vlerëson në mënyrë të vazhdueshme rreziqet dhe krijon fonde rezervë për mbulimin e tyre.”*

Dispozitat e mësipërme, jo vetëm garantojnë të drejtën e subjekteve bankare për të ushtruar veprimtarinë e tyre tregtare bazuar në parimet e tregut të lirë, por vendosin mbi këto subjekte detyrimin për të marrë masa parandaluese dhe monitoruese në mënyrë që të mos ekspozohen ndaj rreziqeve të ndryshme gjatë veprimtarisë së tyre. Në këtë kontekst, ruajtja e Bankës në mënyrë që ajo të mos ekspozohet ndaj rreziqeve, gjithashtu përbën një qëllim të ligjshëm.

Në këto kushte, kur konstatohet se vendimi i Bankës për të mos çelur llogarinë bankare për ankuesin, ka ndjekur një qëllim të ligjshëm, mbetet për t’u vlerësuar nëse plotësohet edhe kushti tjetër, që është fakti nëse ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet.

Bazuar në informacionin dhe aktet e vendosura në dispozicion nga Banka, rezulton se kjo e fundit ka kryer një vlerësim të riskut për rastin e ankuesit, një detyrim ky që duhet të përmbushet prej saj në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin e pastrimit të parave. Në përputhje me kërkesat e vigjilencës së zgjeruar të detyrueshme për t’u zbatuar për PEP, si kategori klientësh që ligji i konsideron *apriori* me rrezik të lartë, vendimi për të mos çelur llogarinë bankare të kërkuar nga ankuesi, është marrë nga drejtuesit e lartë të bankës dhe jo nga dega e Bankës ku ankuesi ka kryer aplikimin për çeljen e llogarisë bankare.

Gjithashtu detyrimi i Bankës për të vlerësuar rrezikun në rastin e ankuesit, është bërë duke u bazuar në faktorë rreziku dhe kategori të faktorëve të rrezikut, të parashikuara sipas ligjit dhe akteve nënligjore të nxjerra nga autoritetet mbikëqyrëse, si dhe akteve të brendshme të Bankës.

Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga Banka, rezulton se për vitet 2019-2020, kjo e fundit ka refuzuar çeljen e llogarive për 124 subjekte, të cilat i përkasin kategorive të ndryshme, përfshirë këtu individë, shoqëri tregtare sh.p.k, persona fizikë tregtare, organizata jofitimprurëse dhe institucione financiare. Referuar listës së klientëve të Bankës, që i përkasin kategorisë PEP, ish prokurorë dhe ish gjyqtarë të shkarkuar nga organet e vetingut, rezulton se nga 101 klientë që i përkasin kategorisë së mësipërme, Banka ka vendosur të vazhdojë marrëdhëniet e biznesit me 57 prej tyre dhe ka ndërprerë marrëdhëniet me 44 të tjerë.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Banka vendosi në dispozicion informacion në lidhje me raste të tjera të ngjashme, kur ajo kishte refuzuar çeljen e llogarive bankare për klientë PEP, ish prokurorë/gjyqtarë të shkarkuar nga organet e vetingut, duke referuar në parashikimet ligjore/nënligjore, si dhe rregulloret e brendshme që rregullojnë parandalimin e pastrimit të parave, por edhe një rast të ngjashëm kur Banka ka vendosur të çelë llogarinë rrjedhëse për subjektin me NIPT xxxxxxxxxx, në datën 12.10.2020. Nga verifikimi i kryer në lidhje me NIPT-in e subjektit për të cilin Banka referon se ka çelur llogarinë rrjedhëse, rezultoi se ky subjekt ushtron aktivitet në fushën e avokatisë, referuar të dhënave të publikuara në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe ka të njëjtin status si ankuesi, ish prokuror i shkarkuar nga detyra nga institucionet e vetingut.

Në kushtet kur, nuk konstatohet ndonjë parregullsi e dukshme ose veprim arbitrar ose subjektiv në vlerësimin dhe matjen e rrezikut për rastin e ankuesit, dhe nga ana tjetër të dhënat e administruara nuk tregojnë ose japin indicie për praktika apo qasje diskriminuese për shkakun e pretenduar nga ankuesi, pra të statusit të tij si ish gjyqtar i shkarkuar nga vetingu, Komisioneri gjykon se bazuar në faktet dhe rrethanat konkrete, vlerësimet e rrezikut për klientë të ndryshëm të Bankës, që kanë të njëjtin status me ankuesin, nuk duhet të jenë objekt shqyrtimi nga ana e Komisionerit, pasi marzhi i vlerësimit i përket vetë Bankës.

Komisioneri vlerëson se, marrëdhëniet ekzistuese midis ankuesit dhe Bankës, për sa i përket depozitave bankare të kursimeve të familjes dhe depozitat bankare të kursimeve të fëmijëve, nuk janë të të njëjtës natyrë me aktivitetin e synuar nga ankuesi në rastin e çeljes së llogarisë si biznes me qëllim ushtrimin e veprimtarisë si avokat, aktivitet i cili për arsytet e parashtruara më sipër përbën një rrezik që i shtohet faktit që ankuesi, për efekt të ligjit është klient me rrezik të lart për shkak se është PEP.

Ligji nr. 917/2008, i ndryshuar dhe Rregullorja e Bankës së Shqipërisë, në lidhje me detyrimin për ushtrimin e vigjilencës së zgjeruar që duhet të ushtrohet, parashikojnë masa minimale, duke i dhënë liri subjekteve që të përcaktojnë kategori të tjera klientësh ose marrëdhënie biznesi ose transaksione, ndaj të cilave duhet të zbatohet vigjilenca e zgjeruar.

Në Rregulloren e Bankës së Shqipërisë, neni 6, pika 14, përcaktohet se: *“Subjektet kryejnë vlerësimin e rrezikut që rrjed nga ekspozimi ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, bazuar në vlerësimin kombëtar të rrezikut të vendit, në kategorinë e klientëve dhe të transaksioneve të kryera, në strategjitë e vetë subjekteve dhe rreziqet e ndërmarra prej tyre si dhe në zhvillimet e*

produkteve të reja dhe përdorimin e teknologjive të reja.” Më tej, në Aneksin I, të rregullores, përcaktohet se: “Në rastet kur subjektet identifikojnë ekspozim të lartë ndaj rrezikut, aplikojnë masa të përforcuara për administrimin dhe zbutjen e ekspozimit ndaj rreziqeve.”

Gjatë shqyrtimit të ankesës, banka prapësoi se vlerësimi i rrezikut dhe vendimi për të refuzuar çeljen e llogarisë për ankuesin, është bazuar edhe në atë që quhet “*risk appetitë*”, që përkufizohet si shuma dhe lloji i rrezikut që një organizatë është e gatshme të ndërmarrë, për të përmbushur objektivat e saj, dhe se gjatë vlerësimit të riskut për ankuesin Banka nuk ishte e gatshme që të ndërmerre një rrezik të shtuar.

Vlerësimin e rrezikut që rrjedh nga ekspozimi ndaj pastrimit të parave, është një detyrim i përcaktuar në Rregulloren e Bankës së Shqipërisë, si më sipër cituar. Referuar ekstraktit të shkëputur nga raporti vjetor i vlerësimit të riskut për pastrim parash për vitet 2018-2019, të vendosur në dispozicion nga Banka, rezulton se kjo e fundit ka patur një trend në rritje të përqindjes së klientëve me risk të lartë, në raport me totalin e klientëve. Sipas të dhënave të vendosura në dispozicion rezulton se për vitin 2018 klientët me risk të lartë kanë përfaqësuar 1.38 përqind të totalit të klientëve, ndërsa në vitin 2019 ky tregues ka shkuar në 1.77 përqind. Sipas të dhënave, rezulton se rritja e këtij treguesi është ndikuar nga rritja e numrit të PEP.

Sa më sipër, rezulton se Banka ka identifikuar një ekspozim të lartë ndaj rrezikut që rrjedh si pasojë e rritjes së numrit të klientëve PEP, e për pasojë ajo legjitimohet që të aplikojë masa të përforcuara për administrimin dhe zbutjen e ekspozimit ndaj rreziqeve. Në këtë kontekst, ulja e numrit të personave PEP, do të sillte si pasojë uljen e numrit të klientëve me rrezik të lartë dhe për rrjedhojë edhe uljen ose zbutjen e ekspozimit ndaj rreziqeve.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se vendimi i Bankës për të mos çelur llogarinë bankare për ankuesin, është një masë e përshtatshme për të ulur ekspozimin ndaj rrezikut të pastrimit të parave dhe është në përpjestim të drejtë me nevojën që ka diktuar në marrjen e saj nga ana e subjektit, pasi të dhënat mbështesin pretendimin e Bankës, se niveli i rrezikut për pastrim parash ndaj të cilit ajo ka qenë e ekspozuar ka pësuar rritje. Bazuar në ligjin nr. 9662/2006, i ndryshuar dhe në Rregulloren e Bankës së Shqipërisë “*Për parandalimin e pastrimit të parave*”, Banka ka pavarësi për të vlerësuar ekspozimin ndaj rreziqeve në përgjithësi duke përfshirë rrezikun për pastrim parash dhe se vlerësimi i rrezikut nga ana e Bankës është ushtruar në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në arritjen e këtij përfundimi, Komisioneri mban në konsideratë edhe opinionin e Bankës së Shqipërisë, sipas të cilit Banka ka pavarësinë që mbështetur në politikën dhe aktet e brendshme rregullatore të hyjë në marrëdhënie biznesi ose jo, të vazhdojë ose ndërpresë këtë marrëdhënie me klientët.

Duke u bazuar në analizën dhe konkluzionet e arritura si më sipër, Komisioneri vlerëson se vendimi i Bankës për të refuzuar çeljen e llogarisë bankare për ankuesin, ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm dhe për rrjedhojë diferenca në trajtim nuk përbën diskriminim. Në këto kushte, Komisioneri arrin në përfundimin se Banka, nuk ka shkelur parashikimet e ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit A.Ç, për shkak të gjendjes shoqërore në ofrimin e shërbimeve bankare, nga ana e Shoqërisë Raiffeisen Bank sh.a.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Gjendja shoqërore
Fusha: Ofrim i shërbimeve bankare
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim